

SHËRBIMET NDIHMËSE



Shërbimet ndihmëse janë shërbime, që kërkohen nga një fëmijë që është në *edukim special*. Shërbimet e ndihmojnë fëmijën me paaftësi, të përfitojë nga ky program, duke marrë ndihmë shtesë dhe mbështetje në fushat që ai ka nevojë, si të folurit ose të ecurit. Shërbimet ndihmëse mund të përfshijnë, por nuk kufizohen te ndonjë prej më poshtë:


- Shërbime për të folurit, artikullimin e fjalës dhe për dëgjimin
- Shërbime për interpretimin
- Terapi fizike dhe profesionale
- Shërbime mbështetëse për shikimin
- Shërbime për lëvizjen dhe orientimin

Teknologjia që do të përdoret përcaktohet prej ekipit të IEP për garantimin se të gjithë nxënësit kanë akses të barabartë në pranim dhe përfitimin nga procesi mësimor.

Vartësisht prej nevojave të nxënësit, shërbimi për të folurin, për shikimin dhe/ose dëgjimin mund të jetë e vetmja kërkesë shërbimi për një nxënësit të edukimit special. Në rast se terapia fizike, ose profesionale është e vetmja mbështetje e kërkuar, mund të përpunohet Plani Kapitulli 15/504 (Chapter 15/504) për zbatim, në vend të IEP.

MBËSHTETJE PËR SHIKIMIN

Mësuesi i mbështetjes për shikimin punon me nxënësin, pasi referohet prej mjekut ophthalmologist. Nxënësit me probleme të shikimit variojnë nga ata me shikim të dobët deri te verbëria e plotë. Sipas referimit nxënësit i bëhet një vlerësim për të përcaktuar akomodimin dhe adoptimin e nevojshëm, që nxënësi të marrë pjesë me sukses në programin mësimor.



Vartësisht prej shkallës së pengesave pamore, nxënësi mund të përdorë tekste me shkronja të mëdha, mjete zmadhimi, audio CD dhe mjete të tjera për shkrimin. Kërkesat teknologjike vlerësohen. Disa

nxënës marrin mësim për lëvizjen dhe orientimin nga një mësues i licencuar, që siguron udhëtimin e sigurtë dhe të pavarur. Nxënësit e verbër mësohen si të përdorin teknikat e ecjes përfshirë përdorimin e bastunit të bardhë. Programi i secilit nxënësit është i personalizuar dhe përcaktimi se cili mjet do të përdoret, bëhet gjithashtu në baza individuale.

Mësuesi që mbështet shikimin është pjesëtar i ekipit, që punon nga afër me mësuesin e klasës, prindin, dhe personelin tjetër të shkollës, për të ndihmuar që fëmija me mangësi në shikim, të arrijë potencialet e tij/saj në procesin mësimor. Nxënësit mund të jenë të pranueshëm për mbështetje kalimtare, ose suplementare.

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS



POLITIKA E MOSDISKRIMINIMIT

Drejtorja Arsimore e Filadelfias, një punëdhënëse që ofron barazi në punësim, nuk do të diskriminojë në punësim, në programet mësimore, në aktivitetet bazuar nga raca, ngjyra, besimi fetar, mosha, origjina kombëtare, trashëgimia, paaftësia, seksi, orientimi seksual, pjesëmarrja në sindikata, ose kufizimet në të folurin e Anglishtes. Kjo politikë e mos diskriminimit shtrihet edhe në të gjitha klasifikimet që mbrohen nga ligji. Publikimi i kësaj politike në këtë dokument, bëhet në përputhje me ligjet e shtetit dhe ato Federale, përfshirë Title IX of the Education Amendment of 1972 dhe Sections 503 dhe 504 of the Rehabilitation Act of 1973.

SHERBIMET NDIHMËSE

në

DREJTORINË ARSIMORE TË FILADELFIAS



ZYRA E SHERBIMEVE TE SPECIALIZUARA
Qendra Mësimore
440 North Broad Street – 2nd Floor
Philadelphia, PA 19130

*2014-15 Related Service Brochure
(Albanian)*

*Translation and Interpretation Center
1/2015*

SHERBIMET NDIHMËSE BASHKËPUNIMI KONSULTIMI

Mësuesit specialistë dhe terapistët punojnë nga afër me mësuesit e tjerë, personelin e klasës dhe prindërit, në mënyrë që fëmijët të zhvillojnë aftësitë e nevojshme që të bëhen nxënës efektivë, përgjatë gjithë mjediseve të shkollës. Meqenëse mësimi kryhet në të gjitha mjediset, personeli i shkollës është trajnuar të realizojë qëllimet dhe objektivat e përpunuara nga ekipi i shkollës, sipas rekomandimeve që jepen nga ofruesi i shërbimeve ndihmëse.



Ofruesit e shërbimeve ndihmëse dhe mësuesit

bashkëpunojnë të zhvillojnë konceptet e mësimi të individualizuar, aftësitë e ndryshme të mësimi dhe aftësitë e zhvillimit. Qëllimi i bashkëpunimit është të koordinohet përvoja dhe të plotësohen nevojat e të gjithë nxënësve.

"Nxënësit fitojnë ndaj sfidave të ndryshme kur bashkëpunojnë me mësues, që besojnë se ata janë përgjegjës për të gjithë nxënësit e klasës" (Angle, 1996)

MBËSHTETJA PER SHURDHËT/DËGJIM TË DOBËT

Sigurimi që nxënësit janë në gjendje të ndjekin programin e përgjithshëm mësimor, pavarësisht shkallës së problemeve të dëgjimit, shurdhimit(D/HH) këkon që mësuesit të bashkëpunojnë me personel të ndryshëm (përfshirë audiologjst, mësuesit e klasës, psikologun e shkollës, këshilltarin e shkollës, interpretuesin e gjuhës me shënja dhe prindërit) për të zbatuar programin gjatë gjithë procesit IEP.

Nxënësit pranohen në Mbështetjen D/HH, pasi ekipi IEPshikon informacionin, i cili duhet të përfshijë një audiogramë, e cila është kryer brenda vitit. Ekipi duhet të arrijë në përfundimin, që humbja e dëgjimit ka ndikim të dukshëm në edukimin e nxënësit.

Programimi i D/HH duhet të përfshijë konsultimin dhe/ose mbështetjen e pjesëshme në mjedisin pranë shkollës. Nxënësit që kërkojnë mbështetje të përditëshme për aksesin në mësim, mund të marrin mbështetje në një shkollë ku mbështetja suplementare është e siguruar.

Programimi në bazë klase, ofrohet kur ekipi bie dakord se një pjesë e madhe e kurrikulës duhet të jepet nga një mësues i D/HH kur kërkohet përdorimi i gjuhës së shenjave dhe elementëve specialë gjuhësorë, në përvetësimin e mësimi. Ky model përdoret në klasa ku të gjithë janë shurdhë, ose me probleme të rënda dëgjimore, ose në përfshirje të një klase të rregullt, me mbështetjen që rekomandohet nga ekipi IEP.

Këto mbështetje mund të përfshijnë: vlerësimin nga një mësues D/HH dhe/ose psikologu i shkollës, i cili është kompetent në gjuhën e shenjave (American Sign Language (ASL), interpretuesi gjuhës së shenjave dhe/ose konsultimi me një audiologjist.

TERAPIA FIZIKE TERAPIA PROFESIONALE

Terapia fizike dhe profesionale, janë shërbime që ofrohen për një fëmijë me paaftësi, që të përfitojë në procesin mësimor.

Terapistët profesionalë përdorin aktivitete që lehtësojnë bërjen aktiv të fëmijës në pjesëmarrjen në shkollë, në kryerjen e detyrave të përditëshme për veten, në qëllimet e përditëshme mësimore dhe në bashkëveprimin me të tjerë. Përdorimi i shërbimeve direkte dhe indirekte, si dhe teknologjia asistuese dhe modifikimet e mjedisit bëhen në bashkëpunim të terapistit profesional me prindërit, mësuesit dhe personelin tjetër, për të ndihmuar përvetësimin e programit mësimor nga fëmija.

Terapia fizike në shkollë, fokusohet në aftësitë e fëmijës që të lëvizë sa më i pavarur në mjediset e shkollës. Terapisti fizik i shkollës vlerëson aftësitë e fëmijës për lëvizje në shkollë dhe pjesëmarrje në aktivitetet e klasës.

Ndërhyrjet në terapinë fizike janë konceptuar në aftësimin e fëmijës për mbajtjen dhe ndërrimin e pozicionit në klasë, pjesëmarrjen në aktivitetet e klasës, ecjen e sigurtë në të gjitha mjediset e shkollës, përfshirë shkallët, banjot, kafeterinë dhe oborrin e shkollës.



MBESHTETJA PER KOMUNIKIMIN TE FOLURIT/GJUHËSOR

Mbështetjet për të folurit/gjuhësore, janë shërbime të cilat ndihmojnë fëmijët me vështirësi komunikimi të kenë akses dhe të përfitojnë nga programet e tyre mësimore të rregullta dhe/ose speciale. Pathologu mësimor i Të folurit/Gjuhësor (SLP) mund të ofrojë mbështetje për fëmijën që është diagnostikuar me probleme në artikullimin, gjuhën, rrjedhshmërinë dhe/ose çrregullime/vonesa të zërit. SLP gjithashtu mund të ndihmojë personelin e shkollës në zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi komunikimi që të përdoret nga fëmijët me nevoja shtesë dhe/ose rrugë alternative të komunikimit.



SLP përdor një vazhdimësi modelesh të shërbimeve mësimore që bazohen në nga puna direkte me fëmijën dhe në punën indirekte për mbështetjen e nxënësit, në bashkëpunim dhe konsultim me personelin mësimor që punon çdo ditë me nxënësin. Modeli i shërbimit indirekt, i quajtur Bashkëpunim/Konsultim (Collaborative/Consultation), ka treguar nga përvoja se është praktika më e mirë kur trajton fëmijë që kanë nevojë në përgjithësimin e aftësive të tyre, nga njëri mjedis në tjetrin. Modelet e shërbimeve ndryshojnë në vartësi të kohës dhe rishikohen çdo vit shkollor.

